



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr. 05 Prot  
Dt. 09.07.2021

VENDIM

Nr. 3, datë 21.06.2021

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJITIK”,  
SHOQËRISË “GJEOKONSULT&CO” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratit e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik”, shoqërisë “Gjeokonsult & Co” sh.p.k., me vendndodhje, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

**HEC KAOLINA**

Vepra e marrjes

- X= 500142.576
- Y= 4657856.11
- Z=485 m.m.n.d
- Omes= 4.018 m<sup>3</sup>/s

- Qllog=6.385 m<sup>3</sup>/s
- Qeko=0.38 m<sup>3</sup>/s

### **Godina e Centralit**

- X= 500008.196
- Y=4655525.7
- Z= 446 m.m.n.d
- Fuqia e instaluar N=1750 Kw

3. Zbatimi i kontratës koncesionare nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KBU MAT**

**GJOKË JAKU**

